



RAPORT

MBI PRIORITETET E QYTETARËVE TË MBLEDHURA PËRMES VOTIMIT ONLINE

NË BASHKINË VLORE

2019


Nga të dhënat e përpunuara për Bashkinë Vlorë vërehet se kategoria që është përzgjedhur më shumë nga qytetarët është **Infrastrukturë rrugore** me **30%**. **Shërbimet publike** pasojnë me **26%**. **Bujqësia dhe Zhvillimi Rural** janë përzgjedhur nga **13%** e qytetarëve. Më pas **Arsimi Parashkollor dhe Parauniversitar** **12%**. **Kultura dhe Turizmi** është votuar me **9%** dhe **Rinia dhe Sportet** me **9%**.

- **Nënkategoritë e buxhetit**

Zërat e Buxhetit	Numri i qytetarëve	Përqindja
Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe	190	37%
Ujësjiellës kanalizime	135	25%
Shërbimi i pastrimit	122	23%
Ujitja dhe kullimi	91	17%
Mirëmbajtja e rrugëve rurale	90	17%
Ndriçimi i hapësirave publike	89	17%
Organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive	75	14%
Arsimi 9 vjeçar	64	12%
Banesa sociale	50	9%
Kopështe	32	6%

Nga 10 zërat më të votuar të buxhetit vërehet se nënkategoria **Investime në rrugë urbane, rurale dhe sheshe** është më e votuara nga **37%** e qytetarëve të Vlorës. **Shërbimi i Ujësjiellës kanalizime** janë përzgjedhur nga **25%** e qytetarëve, ndërsa **Shërbimi i pastrimit** është votuar nga 23% e qytetarëve që kanë marrë pjesë në votim. Nga 17% secila janë përzgjedhur **Ujitja dhe kullimi, Mirëmbajtja e rrugëve rurale** dhe **Ndriçimi i hapësirave publike**. **Organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive** është votuar me **14%**, ndërsa **Arsimi 9 vjeçar** me **12%** që vijon me **Banesa sociale 9% dhe Investime në kopështe** janë votuar nga **6%** e qytetarëve për secilën kategori.


- **Prioritetet sipas gjinisë**



Në figurën ku paraqiten Prioritetet sipas gjinisë vërehet se si **Femrat dhe Meshkujt** i kanë dhënë më shumë rëndësi nënkategorisë Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe duke marrë 12% të votave nga Meshkujt dhe 10% nga Femrat. Në vend të dytë për **Femrat** është nënkategoria Arsimi 9-vjeçar 8 %

ndërsa për **Meshkujt** Ujësjiellës-kanalizime 8%. Në vend të tretë për Meshkujt është Ujitja dhe kullimi 7% ndërsa për Femrat Shërbimi i pastrimit 7%.

- **Prioritetet sipas moshës**



Në prioritetet e moshës mbi 55 vjeç janë Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe (22%) Ujitja dhe kullimi (13%) dhe Shërbimi i pastrimit (16%).

Në prioritetet e moshës 46-55 vjeç janë: Investimet në rrugë urbane, rurale, sheshe (14%) Ujitja dhe kullimi (10%) dhe Shërbimi i pastrimit (12%).


Në prioritetet e moshës 36-45 janë përzgjedhur kategoritë Investimet në rrugë urbane, rurale, sheshe (11%), Shërbimi i pastrimit (7%) dhe Ujësjiellës kanalizime (10%).

Në prioritetet e moshës 26-35 vjeç janë Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe (10%), Ujësjiellës kanalizime (8%) dhe Shërbimi i pastrimit (7%).

Në prioritetet e moshës 18-25 vjeç janë Organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive(14%), Investime dhe mirëmbajtje terrenesh sportive(10%), Investime në rrugë urban e, rurale, sheshe (9%).

- **Prioritetet sipas arsimimit**

Prioritetet sipas arsimimit



• Sugjerimet e qytetarëve të Vlorës

1. Investoni në rinovim të ambienteve, paguani infermierët edhe mjekët aq sa duhet se po ikin të gjithë, edhe blini aparatura te reja.
2. Të gjitha janë përtokë!
3. Danke, also të ketë më shumë informacion për çdo gjë që krijohet.
4. Rruga Çamëria, pranë Zgarës Korçare, pjesa e brendshme e lagjes është e pashtuar.
5. Qendra për artin, sportin, krijimi i kushteve të mira për njerzit në nevojë, qendra strehimi për kafshët e rrugëve.
6. Pylli i Sodës është i ndotur. Autobuzat për tek ushqimorja me orare më të zgjatura.
7. Të pajisen shkollat me psikolog dhe me programe këshillimi për universitet. Janë i vetmi institucion që njohin vlerat e femijëve nga afër. Drejtimi i tyre do ketë vlerë shumë më shumë.
8. Një rëndësi e madhe duhet kushtuar lëvizjes së automjeteve në qytet. Sinjalistika më të shpeshta dhe për një ndërgjegjsim më të shpejt të qytetarëve, oficerët e policisë të jenë të pranishëm gjatë ditës në kryqëzime. Gjatë periudhës së Verës, duhen shtuar festat e organizuara nga Bashkia, në breg të detit. Shembull: Pjesa e detit para shkollës së Marinës

mund të përdoret gjatë pasdites deri në orët e vona për festa. Një zbulim i ambientit me drita.

9. Një vend magjik.

10. Vlorë nuk ka një sipërfaqe të gjelbër, pallatet ngjitur me plot kafene dhe pa kënde lojash për fëmijë, në shkallët e pallateve të rinje në qendër të Vlorës ka papasterti dhe objekte të lëna në shkallët nga banorët e pallatit, që nuk lejohet pasi janë pjesë e përbashkët dhe rregullin e vendos BASHKIA, dhe qyteti bëhet i dashur për banorët.

11. "Gjelbërim në rrugën "Gjerjg Kastrioti". Përmirësim i sinjalistikës rrugore në rrugën "Gjerjg Kastrioti". Më shumë aktivitete rinore në qytet.

12. Në rrugën "Jani Kosta" është problem puseta e cila sa herë bie shi bllokohet.

13. Në rrugën "Jani Rexha" ka problem të madh ndriçimi dhe rruga duhet asfaltuar për shkak se sa herë bie shi bëhet baltë e madhe.

14. Rruga Çamëria Vlorë ka nevojë për më shumë gjelbërim.

15. Në Vlorë duhet më shumë ndihma e shtetit për të varfërit dhe personat në nevojë.

16. Probleme elektrike.

17. Infrastruktura në qytetin tonë është shumë e dobët.

18. Mendoj se këto prioritete duhet të rregullohen sa më shpejt.

19. Sinjalistikë e dobët në rrugët e lagjeve, mungesë ndriçimi.

20. Transporti urban në qytetin e Vlorës është i dobët dhe jo efikas, kërkohen autobusa të rinj.

21. Qyteti i Vlorës ka nevojë për më shumë hapsira parkesh sportive si futbollit basketbollit etj.

22. Fëmijët duhet të jenë mbrojtje sociale.

23. Mbrojtja nga zjarret është një kriter që duhet marrë seriozisht.

24. Në Vlorë nuk ka asnjë bibliotekë të financuar nga shteti. ASNJË.

25. Në shkollën Ali Demi nuk kemi palestër.

26. Shërbimi i transportit duhet të përparojë.

27. Rrugët urbane duhen përmirësuar, gjithashtu sinjalistika.

28. Rruga e fshatit Trevllazër.

29. Nuk kam ndonjë.

30. Asfaltimi i rrugës së fshatit Trevllazër, rikonstruktimi i sallës së pallatit të Kulturës hapësira me pemë brenda blloqeve të banimit.

31. Rikonstruksion i shkollës "Jani Minga".

32. Ky vend ka nevojë për të rinj me moral të lartë kombëtar!

33. Shërbimi i transportit, më shumë orare dhe destinacione.

34. Të merren masa për kontrollin e të gjitha ndërtimeve sa të qëndrueshme janë.

35. Është mirë të futësh 1 orë në javë leksion për tërmetet, ujin, zjarrin dhe korrentin.

36. Të rritet shuma e ndihmës ekonomike dhe numri i përfituesve.

37. Në lagjen 10 korriku ka nevojë për ndërhyrje rruge e të tjera.

38. Rritja e kapaciteteve të mbrojtjes civile, krijimi i një muzeu të ri me temë Marinën Shqiptare, krijimi i aktiviteteve në mënyrë që të rinjtë të jenë më të aktivizuar.

39. Vendosja e sinjalistikës rrugore për këmbësorët, vijat e bardha te pjesa kur kalohet nga rruga transballkanike te karburant Vola.

40. Vlorë synon drejtimin drejt turizmit të qëndrueshëm dhe për rrjedhojë lind detyrimi i përmirësimit të infrastrukturës në zonat rurale pasi ato kanë resurse të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit.

41. Sygjerohet qendra aktive shëndetësore në çdo rajon me staf, për ofrimin e shërbimit shëndetësor të urgjencës për banorët e çdo rajoni, pa patur nevojë që çdo rast urgjence të referohet në spital. Sygjerohet mirëmbajtje dhe kolaudim të herpashershëm të banesave

veçanerisht atyre të vjetrave. Ndoshta mirëmbajtje me tarifa sociale që mund edhe të mbulohen nga vet familjet (shërbim restaurimi të ofruara nga bashkia në vlera modeste, krahasuar me çmimet që dikton tregu privat). Sygjerohet ambiente ose hapësira.

42. Të punohet me cilësi, fushat në Lungomare kanë filluar të prishen se punohet pa pikë kontrolli e me materiale jashtë sandartit.

43. Pastrimi i mbetjeve në zonën e Lungomares duhet të jetë më i mirë, sidomos brenda lagjeve.

44. Na duhen sipërfaqe të gjelbërta sepse po kthehemi në qytet betoni duhet rritur kapaciteti për tu përballuar me situata e emergjencave dhe të vendosen personat e duhur në krye.

45. Në zonën e plazhit të vjetër ka nevojë për:

-ndërtimin ose mirëmbajtjen e rrugëve të lagjeve

-shërbimi i pastrimit pothuajse nuk funksionon

-transporti urban është me orar të rrallë dhe të kufizuar

46. Të ndalohet ose ndëshkohet hedhja e mbeturinave në mënyrë masive në pyllin e Sodës.

47. Të ndriçohet zona nga lagjia Cole deri te pylli i Sodës pasi është e frikshme të kalosh pas orës katër që ikën dielli, jemi në punë dhe jemi të detyruar të kthehemi vonë.

48. Qendra për ofrimin e shërbimeve sociale është në nevojë urgjente në bashkinë e Vlorës.

49. Më shumë mundësi argëtimi dhe edukimi pa pagesë ose me një pagesë minimale për fëmijët dhe të rinjtë e qytetit.

50. Të bëhen përgatitje për raste emergjence.

51. Të përfundohet sa më shpejt rikonstruksioni shkollës 24 maji sepse në këtë stinë është shumë e vështirë të bëhet mësimi mbasdite.

52. Të rregullohet rruga e zjarrëfikses.

53. Nuk besoj se zëri dëgjohej vërtet por po i bëjmë qejfin vetes.

54. Pastrimi në njësinë administrative qendër nuk ekziston fare.

55. Kryesorja është nxitja e bizneseve dhe punësimi i banorëve, sidomos të të rinjve.

56. Lagjia 28 Nëntori, 200 metra nga bashkia është. Në këtë lagje në kohë fushatash elektorale kanë ardhur nëpër të gjitha dyert për të kërkuar votat, dhe mbas asaj kohe, froni i ka bërë të etur për para, dhe kjo lagje se ka parë ndonjëherë investimin.

57. Të merren masa për depozitimin e mbeturinave në pyllin e Sodës.

58. Të zëvendësohen pishat e dëmtuara në Lungomare, të shtohet gjelbërimi në lagjen Cole.

59. Pastrimi në zonat turistike sidomos Lungomare dhe Zvernec. Transporti urban duhet të jetë më cilësor. Aktivitete sa më shumë sportive për fëmijët.

60. Ngritja e një qendre komunitare në lagje ose rajon ku vet komuniteti të organizohet për menaxhimin e shumë situatave dhe për përballimin edhe vet në momentet e para të shfaqes së një situatë të tillë. Bashkia të planifikoj një buxhet për pajisjen e kësaj qendre me pajisje emergjence. Ndërtimin e banesave sociale qofte edhe modeste për strehim edhe të shtresave në nevojë por edhe për çiftet e reja që nuk kanë nevojë për një hyrje apartamenti standard. Bashkia duhet të planifikoj buxhet sado modest.

61. Është turp të mos ketë Vlorë ujë të rrjedhshëm dhe të pijshëm.

62. Sa me shumë përkrahje për shtresat në nevojë.

63. Rikonstruksion i shkollës "Jani Minga".

64. Rrugët e lagjes Cole dhe rregullim i shkollës "Jani Minga".

65. Shkolla "Jani Minga" ka nevojë për rregullim.

66. Shtrim i rrugës te Trevllazërit.

67. Lagja 24 Maji ka nevojë për përmirësime.
68. Transporti urban është shumë jo cilësor.
69. Një pjesë e buxhetit duhet të kalojë në investimet në infrastrukturën rrugore, sidomos në zonat rurale. Konkretisht në Njësitë Administrative Qendër dhe Novoselë. Ato kanë qenë dhe në listën e prioriteteve në zgjedhjet e fundit lokale. Mendojë se këto investime do të zgjidhin sado pak nevojat bazike të komunitetit në fjalë.
70. Rama ik!
71. Do të doja të viheshin në qendër të vëmendjes për zgjidhjen sa më shpejt të tyre.
72. Na bëni rrugën me trotuare dhe ndriçim tek hyrja e qytetit "Fabrika e tullave" se latë nam, është dhe hyrja e qytetit!
73. Të pastrohet qyteti dhe të shtrohen rrugët.
74. Rrugët në periferi.
75. Investime në lagjen 24 Maji.
76. Pylli i Sodës, të ketë konvikte në Vlorë.
77. Lagjia Pavarësia, rruga "Beniamin Nela"
78. Të mundësohen takime rehabilitimi për të traumatizuarit.
79. Më shumë pushime për shkollat.
80. Më shumë pushime.
81. Të ketë më shumë aktivitete në mënyrë që të gjithë të marrim pjesë e të aktivizohemi më shumë.
82. Në lidhje me arsimin do më pëlqente që të hapej një web page ku të ketë gjithçka në lidhje me informacionet për nxënësit. Në bibliotekë të ketë më shumë se një kopje të librave, sidomos ata që duhen në shkollë.
83. Dua që bashkia Vlorë të jetë më e mirë nga kujdesi për rrugët dhe gjelbërimet e saj. Të ketë sa më shumë parqe etj.
84. Investime dhe mirëmbajtje në infrastrukturën urbane, në banesa dhe hapsirat e përbashketa. Sygjerohet mirëmbajtje më të kujdesshme dhe të shpeshtë për banesat. Rritje e kërkesës së llogarisë për administratoret e lagjeve. Do të ishte shumë mirë të ofroreshin shërbime sociale në çdo lagje. Të kishte një qendër në çdo lagje ku njerëzit të adresonin problemet e tyre, pa u dashur të shkojnë në bashki. Ofrimi i shërbimit të sigurisë në çdo lagje. I plotfuqishmi i rajonit të jetë më aktiv dhe më i përfshirë.
85. Shërbimi i pastrimit të jetë më korrekt pasi shërbimet publike vetëm pastrojnë kontenierët ndërsa rrugët e bredhshme në lagje as nuk i pastrojnë fare. Të ketë ndriçim funksional pasi ndriçimi rrugor në lagje edhe kur ka defekt nuk riparohet dhe nuk kujdeset askush. Gjithë vëmendja është vetëm në rrugët kryesore. Në lagjet ku ka banesa dhe pallate të vjetra, nuk mirëmbahen fasadat. Gjithçka bëhet në mënyrë private. Bashkia duhet të kujdeset dhe të kontrollojë situatën e banesave të amortizuara.
86. Përmirësim i infrastrukturës rrugore të rruga Harun Panaja. Shtesë për klasa të reja të shkolla "Muco Delo". Projekte për të rinjtë.
87. Të rritet fondi për emergjencat civile. Të përmirësohet ndriçimi publik se bëhemi objekt i vjedhjeve dhe i sigurisë publike. Të sigurohet pastrimi i kanaleve që të mos përmytemi.
88. Të mirëmbahen varrezat e fshatrave, të bëhet rruga për në Kekrovë, të pastrohet kanali i kullimit.
89. Rinia e sotme e shpenzon kohën në mënyrën jo të duhur dhe aktivizimi i saj nëpërmjet aktiviteteve sportive kulturore do të ishte mjaft i mirë.
90. Kanalizimet e ujërave të zeza në lagjet periferike të qytetit.
91. Të zgjidhet problemi i ujërave të zeza në zonën e bregdetit.
92. Të ndriçohen rrugët në fshatrat e Novoselës.

93. Mirëmbajtja e rrugëve dhe ndriçimi i fshatit Dukat.
94. Rregullimi i rrugës dhe ndriçimit tek zjarrëfikësja dhe mbrapa stadiumit.
95. Ofrimi i shërbimeve të rehabilitimit për të rinjtë me probleme të caktuara, shërbim psikologjik falas dhe aftësim për jetën.
96. Fshatrat duhet të kenë të njëjtin trajtim dhe të njëjtat shërbime si qyteti.
97. Të ofrohen shërbime në familje për personat me aftësi të kufizuar, në pamundësi të familjes për ta lëvizur personin dhe për të patur vëmendje të dedikuar kur punohet me të.
98. Ofrimi i shërbimeve të rehabilitimit pa pagesë dhe në mënyrë konfidenciale për ata që kanë nevojë.
99. Të punohet më tepër me punë bindëse për denoncimin e dhënies në falje, sidomos në fshatra ku gruaja konsiderohet si pronë e burrit.
100. Mbështetje konkrete për gratë e dhunuara, të mos lihen në të njëjtën banesë me dhunuesin.
101. Të rritet transparenca e bashkisë dhe dashamirësia për të vënë në dispozicion informacionin.
102. Të ketë mjedise të gjelbërta ku të luajnë fëmijët në çdo lagje.
103. Pastrami i kanaleve kulluese dhe vaditëse, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i tyre gjatë verës për të evituar mushkonjat dhe sëmundjet.
104. Pastrami i kanalit të kodrës dhe kanalizimet e ujërave të zeza.
105. Të përfundohet sa më shpejt rikonstruktimi i shkollës 24 Maji.
106. Jam mësuese. Shkollat duhet të kenë furnizim me ujë dhe ngrohje.
107. Të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë në Novoselë, veçanërisht në stinën e verës.
108. Në Dukat të Ri dhe Dukat fshat të zgjidhet problemi i ujit.
109. Rrjeti i ujit në Bestrovë.
110. Furnizimi me ujë të pijshëm në Babicë të vogël.
111. Furnizimi me ujë të pijshëm në Panaja.
112. Duam vetëm rrugë dhe ujë, të tjerat i bejmë vetë Kerkove.
113. Rrugë dhe ujë në Kërkov.
114. Të rregullohet rrjeti i ujit në Oshtimë.
115. Pse nuk e keni vendosur zhvillimin ekonomik, punësimin e të rinjve, janë fushat më të dobëta dhe për to duhet investuar.
116. Nga fshatrat pothuajse të gjitha gratë janë të mbyllura në shtëpi, nuk e kanë mundësinë e një pune jashtë shtëpisë. Ka që punojnë në bujqësi, por kur është mundësia. Duhet gjetur një zgjidhje si ngritja e industrive pranë fshatrave ose vendosja e një transporti të mirë nga fshatrat në Vlorë për të mundësuar që këto gra të jenë aktive dhe të pavaruara ekonomikisht.
117. Të hapen vënde pune.
118. Të krijohen mundësi për zhvillimin e bizneseve dhe vënde pune.
119. Të punohet me sigurime, me rregulla dhe pagë të denjë.
120. Shërbimet për fermerët të vijnë më afër fshatrave.
121. Në Mifol dhe Akerni të ndërhyet urgjent për sistemin e ujrave të zeza, i cili është bashkë me ujin e pijshëm.
122. Në Novoselë ka gropa septike të lidhura me kanalet nga persona të papërgjegjshëm, të merren masa.
123. Të ndriçohen të gjitha lagjet e Dukatit.
124. Të ndriçohet rruga kryesore e Llakatundit.
125. Të vendosen në funksionalitet të gjitha kanalet kulluese dhe vaditëse Novosel.
126. Të investohet në transport për fëmijët e fshatrave të largët drejt shkollave, ajo që jep DAR nuk mjafton, nuk ta merr njëri përsipër transportin.

127. Të rregullohet uji i pijshëm në Novoselë për të mos patur ndërprerje gjatë verës.
128. Në Dukat të Ri dhe Dukat Fshat duhet punuar për ujin e pijshëm.
129. Të furnizohet me ujë Kërkova.
130. Uji i pijshëm në Kërkov.
131. Të ndalohet derdhja e ujërave të zeza në det.
132. Të ndalohet dedhja e mbeturinave në pyllin e Sodës.
133. Të pastrohet dhe rehabilitohet pylli i Sodës.
134. Duhet mirëmbajtur ndriçimi i qytetit.
135. Të vihet dorë për ndriçimin në lagjet periferike të Vlorës.
136. Në Cole dhe Kume të punohet për ndriçimin.
137. Rruga e zjarrfikëses dhe mbrapa stadiumit të rregullohet.
138. Të mbillen pemë në zonën e Transballkanikës pasi ka ndotje akustike shumë të madhe për banorët e pallateve të asaj rruge, kur zgjohesh në mëngjes të duket sikur ta kanë vënë krevatin në autostradë.
139. Mbjellja e pemëve në Transballkanike për të ulur ndotjen akustike.
140. Më shumë gjelbërim dhe më pak beton në qytet.
141. Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra, të investohet me përgjegjësi, me fidanë cilësor bimësh dhe pemësh.
142. Të ketë parqe të gjelbra në çdo lagje. Të ofrohen shërbime psikologjike falas për ata që kanë nevojë. Të punohet me sigurime, me rregulla dhe pagë të denjë.
143. Të mirëmbahen godinat e shkollave.
144. Të ketë përkujdesje për godinat e kopshteteve dhe çerdhe që kanë lagështi dhe janë mbi kapacitet.
145. Të ofrohen shërbime psikologjike falas për ata që kanë nevojë.
146. Të merren masa për parandalimin e dhunës në familje para se të ndodhi.
147. Të mbeshteten gratë e dhunuara dhe fëmijët e tyre.
148. Të ofrohen shërbime falas për fëmijët e gave të dhunuara.
149. Të ofrohen shërbime të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara.
150. Vlorë i ka të gjitha mundësitë për tu bërë një vend relaksi, ku fëmijet mund t'i rrisësh me të gjitha kushtet. Ka detin, ka natyrën, por duhet të ketë më shumë mundësi ku fëmijët mund të dalin për aktivitete çlodhëse edhe sportive. Janë fushat në Lungomare por do një ditë vetëm të shkosh e të vish deri atje. Duhet ti jepet prioritet arsimit të mesëm që fëmijët të marrin një formim që i përgatit për jetën dhe i orienton sipas aftësive që kanë. Duhet të ketë aktivitete të shumillojshme në qytet.
151. Në zonën e plazhit të vjetër kanalizimet nuk funksionojnë dhe sa herë bie shi ka përmytje. Ka nevojë të ndriçohet pjesa nga Ndërhyrja e Shpejtë e brenda lagjes. Rruga duhet mirëmbajtur ose duhet bërë një herë e mirë.
152. Ka nevojë të rregullohen rrugët brenda lagjeve në pjesën nga lagjia Cole deri te pylli i Sodës.
153. Të ketë më tepër transparencë në detyrat e punonjësve të bashkisë për të ditur ku duhet të drejtohesh për të mbaruar punë.
154. Të ketë më shumë metoda për marrjen e mendimit të qytetarëve si kjo.
155. Të kryhet më mirë pastrimi në lagjet periferike të qytetit.
156. Duhet marrë masa për djegien e mbeturinave buzë lumit në Orikum.
157. Të bëhet funksional shërbimi i pastrimit në Hoshtim dhe Bestrov sepse nuk ka anjë lloj shërbimi deri tani.
158. Të bëhet diçka për pastrimin në Babicë të Madhe ku mbeturinat hidhen në anë të rrugës kryesore.
159. Transporti i fëmijëve të shkollës Dukat.

160. Furgonat të funksionojnë deri vonë, pasi na kufizon punën.
161. Rruga, kanalizimi dhe ndriçimi në pusin e Mezinit.
162. Rruga "Shtjefen Gjecovi", trotuar dhe kanalizim.
163. T'i kushtohet vëmendje pastrimit dhe të rregullohet rruga në zonën kur del nga porti për në plazhin e vjetër.
164. Kopshti në Nartë duhet të rregullohet.
165. Të investohet për rregullimin e rrugëve që të çojnë në tokat bujqësore në Novoselë, është investim direkt në ekonominë e zonës.
166. Të rritet cilësia e godianve sidomos të arsimit fillor, të pajisen me ngrohje.
167. Punësimi i të rinjve. Më shumë aktivitete që i aftësojnë për jetën.
168. Rrugët e fshtarva kanë nevojë të rregullohen dhe të kenë drita, për mos të kufizuar lëvizjen e njërezve, sidomos në dimer.
169. Punësimi, sidomos i të rinjve. Të ketë parqe të gjelbra në çdo lagje.
170. Furnizimi me ujë në Kërkov.
171. Rruga në Trevllazër dhe Skrofotin.
172. Të rregullohet rruga te tregu i madh.
173. Të mbyllen pusetat e zbuluara dhe të gjendet zgjidhje që mos të vidhen më.
174. Rruga nga mbrapa KSHA ka nevojë të rregullohet.
175. Rruga "Jani Kosta"
176. Të merren masa për ujërat e zeza që derdhen në det, të bëhen kanalizime të përshtatshme, sidomos në zonën e detit ku është me rrezik për përhapjen e sëmundjeve.
177. Rruga e Llakatundit ka nevojë për ndriçim!
178. Rruga në lagjen "Maruke" në Dukat.
179. Rrugët brenda Tragjasit.
180. Rruga e varrezave në Drithas.
181. Mbjellje e pemëve në rrugën Transballkanike, është lënë si një zonë e shkretë, pa jetë, vetëm zhurmë.
182. Vendosja e vijave të bardha të karburant Vola, pjesa ku del nga trotuari i Kumes për në skelë.
183. Të përmirësohet infrastruktura e kopshteve dhe çerdheve, të trajnohet personeli.
184. Rregullimi i rrugës në Shushicë.
185. Rrugët e brendshme të komunës qendër janë në mëshirë të fatit.
186. Vendosja e orareve për furgonat e transportit.
187. Kanalizimet e ujërave në të zeza në Mifol, të ndahen nga rrjeti i ujit.
188. Ndriçimi i fshtreve të Novoselës, patrimi i kanaleve, ofrimi i shërbimeve sociale.
189. Të merren masa për djegien e mbeturinave në zonën nga porti në plazh të vjetër, në stinën e verës në darkë nuk kalohet dot nga era e rëndë.
190. Rregullimi i rrugës së zjarrëfikëses.
191. Rruga dhe ndriçimi në Shushicë, punësimi i banorëve, transporti
192. Vendosja e ndriçimit në Kaninë.
193. Mbështetje e grave të dhunuara me strehim dhe ndihmë ekonomike, të caktohet një shumë e bazuar në çmimet e tregut, jo shuma qesharake që është vendosur.
194. Në Dukat të Ri dhe Dukat Fshat ujin e pijshëm
195. Shërbimet për mbrojtjen e grave nga dhuna janë shumë larg viktimave, sidomos në fshatrat larg Vlorës.
196. Ujë, rrugë, punë.
197. Rregullimi i rrugës dhe kanalizimeve mbrapa stadiumit.
198. Rruga te pusi i Mezinit ka nevojë të rregullohet.
199. Të merren masa për ujërat e zeza që derdhen në det.

200. Të realizohen projekte dhe aktivitete për angazhimin e të rinjve që të fitojnë eksperience për vete dhe t'i shërbejnë komunitetit.
201. Të përmirësohet shërbimi i pastrimit në njësinë administrative Qendër.
202. Të sigurohet ndriçimin në të gjithë Dukatin.
203. Të vihet dorë në zonën e Pus Mezinut.
204. Ndriçimi dhe pastrimi në lagjet Cole dhe Kume.
205. Të përmirësohet shërbimi i pastrimit në lagjen "10 Korriku".
206. Qendra për ofrimin e shërbimeve psikologjike pa pagesë ose me një pagesë të reduktuar, sidomos për adoleshentët.
207. Lehtësia për studentët, si transporti dhe ushqimi me ulje.
208. Furnizimi me ujë dhe rruga në Kërkovë.
209. Të investohet në transport për fëmijët e fshatrave të largët drejt shkollave.
210. Më shumë sipërfaqe të gjelbërta në qytet, qendra për ofrimin e shërbimeve sociale pa pagesë për familjet në nevojë, më shumë aktivitete kulturore në qytet, çdo fundjavë duhet të ketë nga një aktivitet.
211. Shërbime mbështetëse për gratë e dhunuara dhe shërbim psikologjik pa pagesë për gratë dhe fëmijët në familje të tilla.
212. Mbledhja e mbeturinave në zonën e Plazhit të Vjetër duhet të jetë më e shpeshtë gjatë verës, kundërmon e gjithë rruga.
213. Bashkia është e madhe dhe është e kuptueshme që nuk ndërhyr dot në çdo cep, por duhet të jenë aktive dhe funksionale organizimet në grupe të vogla qytetarësh, në nivel pallati ose në nivel lagjeje, për të parë më specifikisht problemet dhe për të ndërhyrë për zgjidhje.
214. Në Mifol dhe Akerni të ndërhyhet urgjent për sistemin e ujërave të zeza, i cili është bashkë me ujin e pijshëm.
215. Riparimi i rrugëve dhe ndriçimi në lagjen Kume.
216. Të vendosen vijat e bardha tek vendi ku kalojnë rrugën këmbësorët nga Riviera te Hotel Partner.
217. Është një turp për Vlorën që ka ujë sa për të furnizuar të gjithë Shqipërinë që të ketë ndërprerje të furnizimit me ujë gjatë stinës së verës. Qyteti tregon një fytyrë jo të denjë për pushuesit që vijnë në plazh dhe nuk lahen dot se ka ikur uji. Uji është jetik dhe ndikon në nivelin e jetësës së banorëve dhe në nivelin e të ardhurave nga turizmi. Ka abuzime pafund nga bizneset të cilët e harxhojnë ujin pa kriter dhe ndonjëherë paguajnë më pak se abonentët familjarë. Ka abuzime pafund me shpenzime.
218. Çerdhet dhe kopshtet e Vlorës janë të gjitha mbi kapacitetet, ka nevojë për ngritjen e kopshteve të reja ose shtese të godinave.
219. Të riparohen kopshtet dhe çerdhet që kanë nevojë, të merren masa për ambientet që kanë lagështi, të ndërtohen ose merren me qira godina të reja, pasi janë të gjitha mbi kapacitetet.
220. Mungesa e punësimit për të rinjtë është problemi kryesor ku duhet të investohet.
221. Të gjitha lagjet e Vlorës duhet të trajtohen njëjloj me shërbime, si me pastrim, me transport, me mirëmbajtje rrugësh.
222. Rruga nga zjarrfikësja e tutje ka nevojë të rregullohet një herë e mirë, sado që i hidhet çakull, aty nuk kullon uji dhe njëjloj mbetet.
223. Të ofrohen më shumë mundësi nga të rinjtë dhe të bëhen publike që të përfshihen ata që kanë dëshirë.
224. Të rinjtë kanë nevojë për punë.
225. Rruga e Kërkovës.
226. Të ndërtohen parqe me gjelbërim në çdo lagje.



227. Të mbillen pemë në Transballkanike për të thithur zhurmën dhe pluhurin.
228. Të merren masa për të rinjtë që kanë nevojë për shërbime psikologjike duke i ofruar këto shërbime falas të paktën për minorenët..



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**